VENDIM
Nr.1221, datë 20.8.2011

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT, KANDIDATIT VIJUES TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DEMOKRATIKE NË QARKUN SHKODËR, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 20.8.2011, me pjesëmarrjen e:

Arben Ristani	kryetar
Dëshira Subashi	zëvendëskryetare
Hysen Osmanaj	anëtar
Klement Zguri	anëtar
Vera Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Demokratike në Qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

KËRKUES: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Neni 21, pika 1, neni 164 i ligjit nr 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë".

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr.1834, datë 19.8.2011, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, z.Marlind Myftiu, njofton krijimin e vakancës në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për shkak të vdekjes së deputetit Gëzim Dibra.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

KQZ-ja, me vendimin nr.217, datë 23.5.2009 "Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Demokratike, pjesëtare e Koalicionit Aleanca e Ndryshimit, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2009", ka miratuar listën shumemërore të Partisë Demokratike për të 12 zonat zgjedhore. Lista shumemërore e Partisë Demokratike për qarkun Shkodër e miratuar nga KQZ-ja, ka këtë renditje: me numër rendor 1 (një) Jozefina Filip Topalli, me numër rendor 2 (dy) Astrit Myfit Bushati, me numër rendor 3 (tre) Arenca Vehbi Trashani, me numër rendor 4 (katër) Gëzim Xhemal Dibra, me numër rendor 5 (pesë) Gjok Tom Uldedaj, me numër rendor 6 (gjashtë) Paulin Nikoll Sterkaj, me numër rendor 7 (shtatë) Ndue Llesh Paluca, me numër rendor 8 (tetë) Ramiz Myftar Çobaj, me numër rendor 9 (nëntë) Gjovalin Ndoc Çuni, me numër rendor 10 (dhjetë) Shpresa Eqerem Tepelia dhe me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) Bardh Ali Spahia.

KQZ-ja, me vendimin nr.593, datë 27.7.2009 "Për shpërndarjen e mandateve brenda koalicioneve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 28.6.2009", ka shpërndarë për Partinë Demokratike, pjesëtare e koalicionit "Aleanca e Ndryshimit", 7 mandate. Gjithashtu, me vendimin e sipërcituar, nga lista shumemërore e Partisë Demokratike për zonën zgjedhore qarku Shkodër për zgjedhjet për Kuvendin 2009, janë shpallur fitues kandidatët si më poshtë:

I.	Jozefina	Filip	Topalli
II.	Astrit	Myfit	Bushati

III.	Arenca	Vehbi	Trashani
IV.	Gëzim	Xhemal	Dibra
V.	Gjok	Tom	Uldedaj
VI.	Paulin	Nikoll	Sterkaj
VII.	Ndue	Llesh	Paluca

Me njoftimin e vakancës nga ana e Kuvendit, në respektim të përcaktimeve të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, mandati i kalon kandidatit vijues të listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Shkodër, miratuar me vendim të KQZ-së. Referuar listës shumemërore të Partisë Demokratike për qarkun Shkodër, kandidati, i cili renditet me numër rendor 8, është zoti Ramiz Myftar Çobaj.

Për gjithë sa më sipër, pas vakancës së njoftuar nga Kuvendi, mandati i deputetit të Kuvendit do t'i jepet kandidatit vijues z.Ramiz Myftar Çobaj, i cili renditet përkatësisht me numër rendor 8 në listën e Partisë Demokratike në zonën zgjedhore qarku Shkodër.

PËR KËTO ARSYE,

mbështetur në nenin 21, pika 1, dhe nenin 164, të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë",

VENDOSI:

1. T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Demokratrike qarku Shkodër, z.Ramiz Myftar Çobaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani